
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“King’s Garden” SHPK**

AKTI I THEMEMELIMIT DHE
STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“King’s Garden” SHPK

Ne Tirane, sot me datë, 10.01.2025, me cilesine e “ortakeve themelues:

1. Shoqëria “ NATYRAL INVEST” SHPK, regjistruar me NUIS- L81330006V, përfaqësuar nga administratori i saj, Z. Artur Dojaka, me ID Nr. Personal H00606100P, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me pjesëmarrje në 40% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 4 000 ALL (katër mijë lekë);;
2. Shoqëria “Zurich Investment Group” SHPK, regjistruar me NUIS- M11825004M, përfaqësuar nga administratori i saj, Z. Alban Efthimi me ID Nr. Personal H01013093A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me pjesëmarrje në 40% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 4 000 ALL (katër mijë lekë);
3. Z. Klodian Shatraj , mbajtës i ID Nr. Personal I10226140S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me pjesëmarrje në 10% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 1 000 ALL (një mijë lekë);
4. Z.Olsi Efthimi mbajtës i ID Nr. Personal H80104094S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me pjesëmarrje në 5% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 500 ALL (pesëqind lekë);
5. Z.Andi Efthimi, mbajtës i ID Nr. Personal H80104093K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me pjesëmarrje në 5% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 500 ALL (pesëqind lekë);

*me vullnet të lire, të plote e të singerte, mbeshtetur ne : Ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjin 9723 date 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, Kodin Civil te RSH, vendosën të **themelojnë** dhe të hartojnë **statutin** e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **“King’s Garden” shpk**, (me poshte e quajtur “ Shoqeria “)*

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “King’s Garden” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

1. Shoqeria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
2. Shoqeria “King’s Garden” SHPK, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
3. Secili nga ortaket, gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3


Selia

1. Shoqeria e ka seline kryesore në: Tiranë, Petrelë, Picall, pronë e ndodhur në zonën kadastrale nr.2954, numër pasurie 69/1.
2. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, si dhe adresa të tjera të ushtrimit të aktivitetit, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen, brënda kuadrit ligjor.

Neni 4

Objekti i veprimitarisë:

1. Import, eksport, prodhimi, tregimi me shumicë e pakicë i bimëve dekorative, fidaneve, farërave dhe luleve, i makinerive dhe i pajisjeve të ndryshme për kopshtari. Ndërtim, projektimi dhe zbatimi i veprave dekorative në lidhje me gjelbërime, parqe, pyje, kopshtari, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjisacionin shqiptar në fuqi. Projektimi, krijimi e mirëmbajtja e parqeve natyrale e urbane, të kopshteve, lulishteve e shëtitoreve publike e private, punime infrastrukture për këtë qëllim. Shoqëria ka për objekt zhvillimin e aktivitetit ekonomik në fushën e gjelbërimit, kopshtarisë dhe të inxhinierisë së mjedisit. Projektim e ndërtim impiante ujitjesh si dhe import eksport e tregëti me shumicë e pakicë të herbicideve e plehrave organike e kimike për fidanet e lulet.



2. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te papercaktuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10 000 Lekë, i ndarë në 5 (pesë) kuota.
2. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht:
 - Shoqëria “ NATYRAL INVEST” SHPK, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 40 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlerë te per gjithshme 4 000 lekë
 - Shoqëria “Zurich Investment Group” SHPK, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 40 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlerë te per gjithshme 4 000 lekë.
 - Klodian Shatraj, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 10 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlerë te per gjithshme 1 000 lekë.
 - Olsi Efthimi, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 5 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlerë te per gjithshme 500 lekë.
 - Andi Efthimi, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 5 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlerë te per gjithshme 500 lekë.
3. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
4. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
5. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërbllimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkuhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

4




Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin Neni 9/1 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve te cilët u thirren por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme qe vendosi për zmadhimin e kapitalit.
2. Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejte te nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat qe zoterojnë ne Shoqëri.
3. Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit, kapitali qe nuk është nënshkruar mund te nënshkruhet nga ortaket e tjerë. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë te drejtën pér nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.
4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve me te njëjtat kushte që kërkohen pér ndryshimin e statutit. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.
5. Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.
6. Vendimi pér zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit pér regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Pér Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashëgimisë;
 - d. ç) dhurimit;
 - e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
4. Përgjegjësia e ortakut ndaj te tretëve, pér detyrimet e Shoqërisë, kufizohet në masën e pjesëmarrjes se tij në kapitalin themeltar, në rast se asambleja e ortakëve e miraton kalimin.



5. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë, në rast se asambleja e ortakëve e miraton kalimin.
6. Akti i shitjes së kuotave të kapitalit mund të vendosë kufizime në lidhje me rishitjen e kuotave, përfshirë këtu të drejtën e parablerjes së saj nga ortaku shitës.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
2. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
3. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve, e thirrur në pajtim me ligjin dhe rregullisht e mbledhur, është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës
5. Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar.
6. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
7. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

8. Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme duhet te regjistrohen ne Regjistrin e Vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen

Neni 9/1 Kuorumi dhe vendimarrja

1. Në rastin e marrjes së vendimeve (te zakonshme dhe te kualifikuar), asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
3. Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat (ose 75%) e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 9 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 10

Administrimi

1. Administrator i shoqerise eshte Z. Klodian Shatraj i identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal I10226140S.
2. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.
3. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te asamblese se pergjithshme te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11

Kompetencat

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



The image shows three handwritten signatures in blue ink, each accompanied by a small number (7, 8, 9) above it. The signatures are written in a cursive style and appear to be in Albanian. They are positioned below their respective names, which are also handwritten in blue ink.

- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Administratori ne respekt te dispozitave ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jene te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishme per te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.
- f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

2. Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- a. Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
3. Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimi shqip të shoqerise.
4. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
5. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
6. Administratori, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
7. Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

Neni 12

Viti Financiar

1. Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.
2. Si përashtim, viti i parë finanziar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të

saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Me mbylljen e seçilit vit financiar, Administratori kryen të gjithë veprimet e nevojshme për përgatitjen e bilancit vjetor dhe të dokumenteve kontabile që do të miratohen nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakëve miraton bilancet vjetore ose i kërkon Administratorit, në përpunje me afat ligjore, të kryejë ndryshimet e nevojshme

Neni 13

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
2. Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 14

Ekspertet

1. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithë-vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe e ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 15


Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevit ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronësi te ortakeve të shoqerise.

Neni 16

Prishja e shoqerise

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga nen 3/1 i ligjit 9901 date

9



4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalm sjell pasoja përmarrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe përpali e treta;
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, "Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar pa kryerjen e likuidimit.

Neni 22

Shnderrimi

1. Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te tij në shoqëri aksionare
2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 23

Baza Ligjore

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptare.
2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita perfundimtare

Ky Statut i shoqerise "**King's Garden**" SHPK, u redaktua "ortaket" ne 5 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe me permbytje dhe vlera te njejtë juridike.

**ORTAKET E SHOQERISE
“King’s Garden” SHPK**

Shoqëria “ NATYRAL INVEST” SHPK,
përfaqësuar nga administratori i saj,
Z. Artur Dojaka



Shoqëria “Zurich Investment Group”
përfaqësuar nga administratori i saj ,
Z. Alban Efthimi



Klodian Shatraj

A handwritten signature in blue ink.

Olsi Efthimi

A handwritten signature in blue ink.

Andi Efthimi

A handwritten signature in blue ink.